

VENDIM
Nr. 86, datë 31.5.2019

MBI MIRATIMIN E “MARRËVESHJES PËR SIGURIMIN E SHËRBIMIT TË SHPËRNDARJES SË ENERGJISË ELEKTRIKE” NËNSHKRUAR MIDIS OSHEE SHA DHE “ReNRGY TRADING GROUP” SHPK

Në mbështetje të nenit 16 dhe 20, germa “h”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar nenit 26 të “Rregullave të organizimit, funksionimit dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016, nenit 20, pika 1, të Marrëveshjes së sigurimit të shërbimit të shpërndarjes së energjisë elektrike ndërmjet Operatorit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike dhe Furnizuesit të Energjisë Elektrike, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 24, datë 15.2.2017, ndryshuar me vendimin nr. 58, datë 15.4.2019, Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 31.5.2019, mbasi shqyrtoi relacionin e drejtorive teknike në lidhje me miratimin e marrëveshjes për sigurimin e shërbimit të shpërndarjes së energjisë elektrike nënshkruar midis shoqërisë OSHEE sh.a. dhe shoqërisë “ReNRGY TRADING GROUP” sh.p.k.,

konstatoi se:

- Shoqëria OSHEE sh.a., me shkresën nr. 7711/3 prot., datë 17.5.2019, protokolluar me tonën me nr.352 prot., datë 20.5.2019, ka dërguar në ERE “Marrëveshjen për sigurimin e shërbimit të shpërndarjes së energjisë elektrike të nënshkruar midis OSHEE sh.a. dhe “ReNRGY TRADING GROUP” sh.p.k., më datë 17.5.2019, me qëllim miratimin nga ERE të kësaj marrëveshje në zbatim të vendimit të Bordit të ERE-s, nr. 24, datë 15.2.2017, “Mbi miratimin e marrëveshjes së shërbimit të shpërndarjes së energjisë elektrike ndërmjet OSHEE sh.a. dhe furnizuesit të energjisë elektrike”, i ndryshuar me vendimin nr. 58, datë 15.4.2019.

- ERE, me vendimin e Bordit nr.245, datë 26.11.2018, ka licencuar shoqërinë “ReNRGY TRADING GROUP” sh.p.k. në aktivitetin e furnizimit të energjisë elektrike, për një afat 5-vjeçar.

- Bordi i ERE-s me vendimin nr.96, datë 27.10.2014 ka licencuar shoqërinë “Operatori i Shpërndarjes të Energjisë Elektrike” sh.a. në aktivitetin e shpërndarjes së energjisë elektrike”, për një afat 30-vjeçar, i ndryshuar me vendimin nr. 216, datë 11.10.2018 dhe me vendimin nr. 264, datë 20.12.2018.

- Në marrëveshjen e miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s sa më sipër cituar nr.24, datë 15.2.2017 “Mbi miratimin e marrëveshjes së shërbimit të shpërndarjes së energjisë elektrike ndërmjet OSHEE sh.a. dhe furnizuesit të energjisë elektrike”, i ndryshuar me vendimin nr.58, datë 15.4.2019 është parashikuar në nenin 20, pika 1 të saj përcaktohet se, *“Kjo Marrëveshje hartohet në 5 kopje origjinale, në gjuhën shqipe, secila me vlerë të njëjtë ligjore, 2 për secilën Palë dhe 1 për t’u dërguar për miratim në ERE dhe pikën 20.2 se, Palët deklarojnë se nënshkrimi i kësaj Marrëveshje bëhet me vullnetin e tyre të lirë dhe të plotë dhe se ky nënshkrim ka fuqi për shoqëritë të cilët ata përfaqësojnë.*

- Në lidhje me përmbajtjen e kësaj marrëveshje, e nënshkruar dhe e dakordësuar mes palëve, konstatojmë se kanë reflektuar të gjitha dispozitat që ERE ka parashikuar në marrëveshjen TIP të cilën e ka miratuar dhe ndryshuar se fundmi me vendimin nr. 58, datë 15.4.2019.

- Marrëveshja është hartuar në përputhje me aktin e miratuar nga Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 24, datë 15.2.2017, “Mbi miratimin e marrëveshjes së shërbimit të shpërndarjes së energjisë elektrike ndërmjet OSHEE sh.a. dhe furnizuesit të energjisë elektrike”, i ndryshuar me vendimin nr.58, datë 15.4.2019.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Miratimin e kërkesës së shoqërisë OSHEE sh.a. për “Miratimin e marrëveshjes për Sigurimin e Shërbimit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike nr.7711/3 prot., datë 17.5.2019 nënshkruar midis shoqërisë OSHEE sh.a. dhe shoqërisë “ReNRGY TRADING GROUP” sh.p.k.

2. Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojë subjektet e interesuara për vendimin e Bordit të ERE

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim brenda 7 ditëve kalendarike, si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti